



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1002 prot.

Tiranë, më 28 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 128 , datë 28 . 05 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, mori në shqyrtim ankesën nr. 258 Regj., datë 06.11.2025, e Shoqërisë “TETE Albania Tunnel & Mining sha”, C. Y.² dhe H. U³, kundër Konfederatës së Sindikatave në Shqipëri dhe Presidentit të saj, K. N, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “racës, etnisë, shtetësisë dhe bindjeve fetare”.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Referuar ankesës dhe dokumentacionit të depozituar, subjektet ankues, ndër të tjera, parashtrojnë se: “Shoqëria “TETE Albania Tunnel & Mining” sh.a. është një shoqëri tregtare e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT K71627041B, më datë 11.04.2007. Si pjesë e aktivitetit tregtar, shoqëria merret me kërkimin, nxjerrjen, përpunimin, tregtimin dhe eksportimin e mineraleve dhe materialeve natyrore, në disa zona gjeografikë ku është e mundur nxjerrja e mineraleve nga nëntoka. Një prej vendeve të ushtrimit të aktivitetit të saj është edhe Miniera e Bakrit në Gurth-Spaç, Lezhë, për të cilën Shoqëria është pajisur me licencat përkatëse.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Me detyrë Drejtor i Përgjithshëm pranë kësaj Shoqërie.

³ Me detyrë Drejtor Administrativ i kësaj Shoqërie.

C. Y dhe H. U janë respektivisht Drejtor i Përgjithshëm dhe Drejtor Administrativ të Shoqërisë.

Më 26.08.2025, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), i është drejtuar “TETE Albania Tunnel & Mining” sha me kërkesë për takim pune, duke njoftuar se kishte shtrirë aktivitetin sindikal në këtë shoqëri dhe kishte krijuar Këshillin Sindikal të Minierës së Spaçit.

Më 18.09.2025, KSSH kërkoi nisjen e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës, por “TETE Albania” fillimisht nuk pranoi pasi konstatoi se mandati i Presidentit të KSSH kishte përfunduar, e gjithashtu mungonte prova e përfaqësueshmërisë së punonjësve dhe nuk ishte e qartë lidhja e Konfederatës me organizatat sindikale të tjera, duke vënë në dyshim legjitimitetin e këtij subjekti. Prandaj duke qenë në këto kushte, i është kërkuar qartësimi dhe rregullimi i problematikave të evidentuara. Duhet të theksohet se KSSH në asnjë moment nuk shprehu vullnet për respektim të procedurave ligjore.

Në 8–10 tetor 2025, KSSH filloi duke organizuar greva të paligjshme e të panjoftuara, që sollën mungesën e 40 punonjësve dhe rrezik për incidente teknike në minierë, si pasojë, Shoqëria u detyrua të ndërpriste aktivitetin, duke pësuar dëm ekonomik. Pas realizimit të dy grevave të para, më 09.10.2025, KSSH njoftoi për një grevë të përgjithshme pa afat në datën 13.10.2025, ndonëse nuk kishte zhvilluar bisedime paraprake apo proces ndërmjetësimi, dhe që nga ajo kohë ka pasur një vazhdimësi të grevave të pa ligjshme nga ana e KSSH.

Kështu rezulton se aktiviteti i shoqërisë “TETE Albania Tunnel and Mining” sha ka qenë i paralizuar për ditë të tëra dhe vijon të jetë i tillë. Që nga ky moment, përveç dëmit ekonomik të pësuar nga ndërprerja e punës, cënimi i reputacionit është një element tepër i rëndësishëm për rastin në fjalë, pasi për gjatë gjithë veprimeve të pa ligjshme të ndërmarra nga Konfederata, kemi konstatuar një sulm, me nocion racor, fetar dhe etnik në rrjetin social Facebook në mënyrë të egër dhe të vazhdueshme nga ana e Konfederatës së Sindikatave duke etiketuar dhe sulmuar në mënyrë te drejtpërdrejtë shoqërinë “TETE Albania” dhe drejtuesit e kësaj Shoqërie duke nxitur urrejtje dhe grindje me karakter racor, fetar dhe etnik dhe duke përhapur shkrime me karakter të tillë, duke diskriminuar drejtpërdrejt shoqërinë dhe dy ankuesit që janë punonjës të saj.

Më poshtë do të listojmë sipas kronologjisë së publikimit të tyre, disa nga postimet të KSSH me qëllim diskriminimin e ankuesve, për shkak të racës, etnisë, dhe fesë.(analizuar më poshtë në vendim)

Subjektet ankues kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Konstatimin e diskriminimit përmes përdorimit të gjuhës së urrejtjes, me nocion racor, fetar dhe etnik, në mediat sociale nga ana e Konfederatës së Sindikatave në Shqipëri dhe K. N si përfaqësues ligjor i saj.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 1553/2 prot., datë 18.11.2025, ka kërkuar nga Konfederata e Sindikatave në Shqipëri/KSSh, të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me pretendimet për gjuhën e përdorur në publikimet respektive në Facebook.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 865 prot., datë 02.12.2025, KSSh, ka dërguar pranë KMD-së, parashtrime, duke cituar si më poshtë:

“Është e vërtetë se me datë 16.08.2025, punonjësit e Minierës së Bakrit në Spaç, kanë nënshkruar anëtarësimin e tyre në KSSh dhe në Sindikatën e Sektorit të Minierave në FSPISH (pjesë e KSSh).

Po më datë 16.08.2025, u zhvillua mbledhja për zgjedhjen e organeve drejtuese të Organizatës Sindikale të Minierës së Bakrit Spaç, në të cilën morën pjesë 65 anëtarë, në përfundim të të cilës në Kryesinë e Këshillit Sindikal u zgjodhën 6 anëtarë.

Zhvillimi më datë 08.10.2025 i mbledhjes së jashtëzakonshme të Organizatës Sindikale të Miniatorëve të Minierës së Bakrit Spaç.

Më datë 07.10.2025 (ditë e martë), pas shkarkimit të menjëhershëm, të qëllimshëm dhe të paparalajmëruar nga puna, të minatorit z. A. B (i cili po punonte 16 orë rrjesht, përgjegjës turni dhe drejtues teknik) dhe lënies më pas të minatorëve të tjerë pa asnjë drejtues teknik, Këshilli

Sindikali i Minierës së Bakrit Spaç vendosi të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Organizatës Sindikale të Minatorëve të Minierës së Bakrit Spaç për të diskutuar në këtë mbledhje në lidhje me përshkallëzimin e përkeqësimit të marrëdhënieve të punës të minatorëve të Minierës së Bakrit Spaç, si pasojë e veprimeve të papërgjegjshme dhe arrogante të administratorit C. Y.

Më datë 08.10.2025 (ditë e mërkurë), Organizata Sindikale e Minatorëve të Minierës së Bakrit Spaç zhvilloi mbledhjen e saj të jashtëzakonshme, të thirrur një ditë më parë nga Këshilli Sindikal, në të cilën morën pjesë pa përjashtim të gjithë minatorët anëtarë të Sindikatës. Mbledhja u shoqërua me mbajtjen e një procesverbali, në të cilin evidentohet fare qartë se kush e thirri mbledhjen e jashtëzakonshme, cilët ishin pjesëmarrësit dhe të ftuarit, çfarë diskutuan, propozuan dhe votuan minatorët dhe çfarë suporti dhe këshillash ofroi KSSH që ishte ftuar në këtë mbledhje.

Në përfundim të mbledhjes, minatorët me votë unanime vendosën që:

- Më datë 13.10.2025 (ditë e hënë), ora 07:00, minatorët do të fillonin një grevë pa afat, në ambientet përpara hyrjes kryesore në kompaninë “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha, pa cenuar pronën, dinjitetin e punëdhënësit apo të punëmarrësve të tjerë të cilët me vullnetin e tyre individual do të shprehnin dëshirën për tu paraqitur gjithsesi në vendin e tyre të punës, duke patur mundësinë për të hyrë në punë nga dy hyrjet e tjera që nuk do ishin të bllokuara;*
- Për zhvillimin e grevës dhe përfaqësimin e grevistëve në negociata me punëdhënësin minatorët votuan dhe zgjodhën Komisionin e grevës të përbërë nga 6 anëtarë.*

Referuar përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes, në të evidentohen në total tetë arsye që i çuan minatorët në marrjen prej tyre të vendimit për zhvillimin më datë 13.10.2025 (ditë e hënë), ora 07:00, të një greve pa afat, dhe më konkretisht:

Së pari, fakti që përgjatë dy muajve të fundit (gusht – shtator 2025) minatorët në përgjithësi dhe drejtuesit e Sindikatës në veçanti kishin qenë nën një presion dhe kërcënim të vazhdueshëm psikologjik, fizik dhe zyrtar nga ana e administratorit të “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha, C Y, duke i thirrur ata një e nga një në zyrë, duke i intimiduar dhe duke i kërcënuar ata që të largohen detyrimisht nga Sindikata, duke ju thënë që nëse ata do të largoheshin nga Sindikata atëherë ai ishte i gatshëm që t'u plotësonte atyre të gjitha kërkesat, duke ju thënë që Sindikatën nuk e do pronari i madh në Turqi, duke i rënë tavolinës fort me grusht dhe duke ju thënë që nëse ata do të vazhdonin në këtë mënyrë do të largoheshin nga puna menjëherë.

Së dyti, fakti që më datë 07.10.2025 (ditë e martë), administratori i “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha, i kishte kërkuar punëmarrësit z. A. B, i cili punonte 16 orë pa ndërprerje (minator, përgjegjës turni dhe drejtues teknik), në mes të turnit, që të largohej në mënyrë të menjëhershme nga puna. Në dukje kjo kërkesë e administratorit justifikohet prej tij me pretendimin që z. A. B, si përgjegjës turni, pas aksidentit në punë pa pasoja të ndodhur më datë 05.10.2025 (ditë e dielë), nuk kishte plotësuar formularin HSE-P03-F01 dhe kjo përbente një shkelje të rëndë të marrëdhënieve të tij kontraktore, por në fakt e gjithë kjo ishte një sebep që administrator e shfrytëzoi

për të hequr me çdo kusht nga puna z. A. B, për t'i dhënë minatorëve të tjerë një mesazh force dhe kërcënues.

Ndryshe nga sa pretendohet, aksidenti në punë i ndodhur më datë 05.10.2025 (ditë e dielë) nuk kishte patur asnjë pasojë. Minatori i dëmtuar ishte dërguar nga ana e A. B, si përgjegjës turni, menjëherë në ambulancë dhe punonjësi shëndetësor nuk e pa të arsyeshme që punëtori i dëmtuar të trajtohej më tej sepse plaga ishte jo problematike dhe nuk e pengonte atë që të vazhdonte punën.

Ndërkohë formulari HSE-P03-F01 qëllimisht nuk ishte në gjendje në frontin e punës, as ditën e dielë kur ndodhi aksidenti dhe as ditën e hënë, pavarësisht kërkesave të A. B. Ky formular nuk ju dha qëllimisht A. B në mënyrë që të kalonte afati 24 orë i mosplotësimit të këtij formulari dhe më pas mosplotësimi i këtij formulari të konsiderohej si faj i rëndë dhe për rrjedhojë të justifikohet largimi i tij i menjëhershëm nga puna.

Minatorët e turnit, kur morën vesh që administratori i “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha largoi menjëherë nga puna dhe në mënyrë demonstrative dhe denigruese z. A. B, duke mos e lënë atë as që të merrte sendet e tij personale, ndërprejnë të gjithë punën dhe kërkuan që të mos vazhdonin më punën pa patur një drejtues teknik për të mbikëqyrur sigurinë e tyre në frontet e nëntokës. Kjo kërkesë nuk ju plotësua minatorëve as më datë 07.10.2025 dhe as më datë 08.10.2025.

Pra kjo ngjarje ishte një ngjarje e paralajmëruar më parë në kërcënimet e administratorit të “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha, dhe ishte një mesazh për të gjithë minatorët e tjerë në lidhje me kërkesat e tyre.

Së treti, fakti që situata në minierë ishte shumë e vështirë dhe nuk respektohej asnjë rregull i sigurisë dhe i shëndetit në punë. Minatorët punonin me orë të zgjatura, në pluhur, në lagështirë. Pavarësisht se punëtorët ishin në një sistem 3 turnësh dhe ata duhet të punonin 8 orë në ditë dhe 5 ditë në javë, punëdhënësi i kishte vendosur që dita e punës të ishte 7 orë në ditë dhe për rrjedhojë ata të dilnin në punë edhe ditët e shtuna. Për këtë gjendje kishin faj edhe strukturat shtetërore të cilat në vend që të ushtronin kontrollë ishin bërë palë me punëdhënësin dhe ishin korruptuar prej tij, duke marrë prej tij karburant, duke ngrënë prej tij në restorante apo duke marrë prej tij çdo muaj pagesa nën dorë.

Së katërti, fakti që punonjësit me shtetësi turke që punonin në Minierë, për të njëjtën punë që ata kryenin njëlloj si dhe punonjësit me shtetësi shqiptare, paguheshin disa herë më shumë dhe kishin edhe përfitime të tjera materiale.

Së pesti, fakti që minatorët kishin tentuar edhe 2 herë më parë që të organizoheshin dhe funksiononin si Sindikatë por kishin dështuar për shkak që këtë herë nuk duhet të tërhiqeshin pavarësisht se administratori i “TETE Albanian Tunnel and Mining” sha, do tentonte ti përçante, duke i larguar minatorët një e nga një nga puna, njësoj si z. A. B.

Së gjashti, fakti që përgjatë kësaj periudhe administratori i “TETE Albanian Tunnel and Minning” sha, jo vetëm që nuk respektonte dhe nuk pranonte Sindikatën por madje pretendonte edhe që KSSH ishte një organizatë e paligjshme.

Së shtati, fakti që Sindikata i kishte kërkuar disa herë punëdhënësit që të uleshin, të bisedonin dhe të negocionin, por punëdhënësi në mënyrë demonstrative kishte refuzuar si takimet dhe negociatat ashtu dhe idenë e nënshkrimit të një kontrate kolektive të punës, përmes së cilës minatorët donin të sistemonin pagat, shpërblimet, kohën e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë. Gjatë gjithë kësaj periudhe punëdhënësi kishte shfaqur me minatorët një sjellje arrogante dhe të papërgjegjshme, duke mos pranuar asnjë lloj dialogu dhe bisedimi me ta. Për rrjedhojë e vetmja rrugë që u mbetej minatorëve për të arritur që të dëgjohen në lidhje me kërkesat e tyre të ligjshme dhe të drejta ishte ajo e zhvillimit të një greve. Minatorët i kishin ezauruar të gjitha mjetet dhe mundësitë e tyre por punëdhënësi kishte vazhduar që të mbetej arrogant dhe nuk pranonte të ndërtonte asnjë urë komunikimi as me minatorët dhe as me Sindikatën e tyre. Për rrjedhojë greva ishte e detyrueshme dhe e vetmja rrugë.

Së teti, fakti që punëdhënësi kishte dëmtuar dhe po vazhdonte të dëmtonte pronat dhe tokat e punëmarrësve dhe të komunitetit, duke derdhur në to dampat dhe kimikate squfuri dhe duke infektuar të gjithë burimet ujore dhe tokat përreth minierës të mbjella nga komuniteti me perime dhe fruta.

Ndërkohë referuar përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes, në të evidentohen fare qartë qëndrimi i minatorëve që ata e konsiderojnë veten jo vetëm anëtarë të Sindikatës por edhe anëtarë të KSSH dhe që ata ishin të ligjshëm në aktivitetin e tyre sindikal pavarësisht dëshirave dhe presionit të administratorit.

Suporti që KSSH i ofroi minatorëve pasi ata morën vendimin për zhvillimin e grevës konsistonte në:

- gatishmërinë e KSSH për ti mbështetur minatorët me asistencë teknike dhe ligjore për zhvillimin e grevës në mënyrë që greva të ishte sa më e suksesshme dhe sa më e shkurtër me qëllim që humbjet për të gjitha palët të ishin sa më minimale; dhe*
- gatishmërinë e KSSH që po atë ditë (pra që më datë 08.10.2025) të njoftonte me shkresë zyrtare për zhvillimin e grevës si punëdhënësin ashtu dhe të gjitha strukturat përkatëse shtetërore.*

Ndërkohë, këshilla që KSSH i dha minatorëve pasi ata morën vendimin për zhvillimin e grevës ishte që:

- Komisioni i grevës të mbante lidhje të vazhdueshme me punëdhënësin dhe përfaqësues të tij dhe ti kërkonte punëdhënësit hartimin e një plani emergjent për ruajtjen e pajisjeve, mjeteve dhe vendeve të punës;*

- Komisioni i grevës ti kërkonte punëdhënësit që të njoftonte nënkontraktorët, furnitorët dhe personat apo subjekte të tjera që minatorët do ishin në grevë dhe që për këtë arsye gjatë kësaj periudhe aktiviteti i minierës do të kufizohej deri në ndërprerje të plotë; dhe
- Komisioni i grevës të bashkëpunonte me firmën e rojeve të sigurisë private që të rakordonin aktivitetet dhe të mos kishte problem apo keqkuptime për fillimin dhe vazhdimin e grevës.

Pra referuar përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së datës 08.10.2025, KSSH në këtë mbledhje ka mbajtur një qëndrim mëse konstruktiv, bashkëpunues dhe të drejtë për të gjitha palët. Si për punëmarrësit ashtu dhe për punëdhënësin dhe palët e treta që do prekeshin apo kishin një rol të caktuar në raport me grevën e minatorëve.

Kjo ishte e vërteta në lidhje me grevën, legjitimitetin e saj dhe respektin dhe integritetin e KSSH-së për vete dhe për çdo palë të përfshirë në proces.

Në lidhje me ankimin për pasqyrimin në rrjetet sociale të KSSH-së nga ana e KSSH-së nuk ka pasur asnjë fyerje apo tendencë për fyerje, diskriminim, apo tjetër kategori që ankuesi pretendon. Të qenurit shtetas me kombësi turke, apo shtetas me kombësi shqiptare është një realitet i pakontestueshëm për këdo dhe është nder për këdo që mban pashaportën e vendit dhe të kombit të tij.

Në të gjithë pretendimet që ankuesi pretendon ne kemi shpërndarë postime që nga rrjete gazetarie investigative apo portale të rrjeteve sociale kanë hulumtuar apo komentuar për kompaninë “TETE Albania Tunnel & Mining” sha. E kundërta ka ndodhur pasi kompania ka angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklarata shtypi që të tërthortë duke inkurajuar portale të rrjeteve sociale që shpifin ndaj KSSH-së dhe lidershit të saj. Probleme të cilat KSSH po i ndjek në rrugë ligjore.

Për sa më sipër Ju shpjegojmë se “TETE Albania Tunnel & Mining” sha, ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një padi ndaj të paditurit KSSH me objekt shpalljen e paligjshme të grevës, detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblim, etj.”.

3. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 211 prot., datë 26.01.2026, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.
4. Nëpërmjet e-mailit datë 05.02.2026, përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë “TETE Albania”, av. F. M, ka konfirmuar pjesëmarrjen në seancë, si përfaqësues i Shoqërisë dhe C. Y dhe H. U.
5. Nëpërmjet e-mailit datë 06.02.2026, përfaqësuesit ligjor të subjekteve ankues, i është vënë në dispozicion nga inspektori i çështjes, për njohje paraprake, i gjithë dokumentacioni i depozituar nga KSSH.

6. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 10.02.2026, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit. Subjektet ankues u përfaqësuan në seancë nga Av. F. M⁴, ndërsa Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë dhe Presidenti i saj, u përfaqësuan në seancë nga Av. E. Sh dhe z. K. I, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës së Sindikatës së Industrisë së Shqipërisë, anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së dhe FSPISH-së.⁵

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit ankues mbajti të njëjtin qëndrim, si dhe parashtrori të njëjtat argumente me ato të paraqitura në ankesë, të cilat do të shtjellohen edhe në vijim të këtij Vendimi.

Ndërkohë, nga përfaqësuesit e KSSH-së u parashtruan të njëjtat argumente prapësimi, njëjtë me ato të dërguara shkresërisht para Komisionerit, duke theksuar si më poshtë:

“Ato postime nuk janë të gjitha të publikuara nga KSSH, por janë shpërndarë nga të tjerë dhe janë ripostuar.

Postimi nr. 3 është hequr nga vetë KSSH për shkak të metaforave të përdorura. Në lidhje me shpërndarjet e postimeve, i janë referuar shoqërisë turke, si shoqëri e huaj.

Janë konflikte që ishin për shkak të grevës e që lidheshin me të drejtat e minatorëve. Këto postime janë në kuadër të pretendimeve për të kërkuar të drejtat e tyre, është etiketim jo diskriminim...është aludim për veprime të paligjshme të pretenduara, nuk ka etiketim që të ketë prekur shtetësinë drejtpërdrejtë të dy ankuesve, shtetasve të huaj në lidhje me shtetësinë apo fenë e tyre...”

7. Pas seancës dëgjimore, nëpërmjet e-mailit datë 27.02.2026, KSSH dërgoi pranë KMD-së, parashtrimet përfundimtare, ndër të tjera, si më poshtë citohet:

“Si fillim, referuar vetë përmbajtjes së padisë së paraqitur nga ankuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kundër KSSH-së, rezulton se nga shoqëria “Tete Albania Tunnel & Mining” sha, përveç dëmit pasuror nga zhvillimi i grevës të konsideruar prej saj si të paligjshme është kërkuar edhe dëmi jopasuror dhe në paragrafin 50 të padisë i referohen shprehimisht pretendimeve për thirrje raciste dhe provave që janë paraqitur edhe në procesin administrativ. Pasqyruar ky fakt edhe në paragrafin 6 të ankesës së paraqitur pranë KMD.

Për më tepër, të konfirmuara edhe nga deklarimet e bëra në seancë nga vetë përfaqësuesi i palës ankuese, është pranuar se lidhur me të njëjtat pretendime është paraqitur edhe kallëzim penal pranë organit të prokurorisë.

Në këto kushte, objekti i shqyrtimit administrativ, po shqyrtohet edhe nga gjykata civile ashtu edhe nga organi prokurorisë, dhe se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe para Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

⁴ Referuar “Autorizimit” datë 05.11.2025, të Shoqërisë “TETE Albania Tunnel & Mining” sha, Prokurës së Posaçme me nr. Rep. 263, nr. kol. 78, datë 21.01.2026 dhe Prokurës së Posaçme me nr. Rep. 264, nr. kol. 79, datë 21.01.2026, të Noteres B. Ç/Dhoma Kombëtare e Noterisë/Dega Vendore Tiranë.

⁵ Referuar “Autorizimit” datë 09.02.2026, të KSSH-së dhe “Autorizim Përfaqësimi” datë 16.07.2025, të presidentit të KSSH-së, si dhe deklarimeve gjatë seancës.

Në këto rrethana KMD nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën e shoqërisë “Tete Albania Tunnel & Mining” sha dhe çështja duhet të pushohet.

Së dyti, referuar postimeve që referohet pala ankuese ato përbëjnë në një pjesë të konsiderueshme shpërndarje apo ripublikim të qëndrimeve të personave të tretë, aktivistëve, qytetarëve apo anëtarëve të komunitetit të prekur nga konflikti kolektiv i punës.

Pra, nuk ka deklarime individuale të hartuara personalisht nga drejtuesi i KSSH-së, por me përmbajtje të qarkulluar tashmë në hapësirën publike dhe të integruar në diskutimin sindikal.

Faqja zyrtare në rrjetin social administrohet nga persona të caktuar për komunikimin publik dhe menaxhimin teknik të platformës, në përputhje me praktikën e zakonshme organizative. Nuk është Presidenti i KSSH-së ai që ushtron personalisht administrimin e drejtpërdrejtë të faqes, pasi ai ka faqe të veten personale ku bën publikime individuale.

Ndërkohë duhet të bëhet dallimi ndërmjet autorit të drejtpërdrejtë të një deklaratë të publikuar dhe dhe subjektit që e shpërndan në kuadër të një debati publik. Ripublikimi i një qëndrimi/postimi të një të treti nuk ka të njëjtën vlerë në lidhje me formulimin e përdorur në postim me mendimin apo shprehjen personale të atij që e publikon, pasi përbën pjesëmarrje në një debat publik, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje me interes të lartë shoqëror.

Duke analizuar përmbajtjen e postimeve, ato duhet të lexohen në kontekstin e një konflikti kolektiv pune dhe të një debati mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore, transparencën financiare dhe ndikimin në komunitetin lokal.

Në përfundim, as nga aspekti i autorësisë, as nga analiza materiale e përmbajtjes dhe as nga standardi i përgjegjësisë në hapësirat dixhitale, nuk rezulton përmbushja e elementeve përbërës të diskriminimit.

Në rastin konkret, nga analiza e tërësisë së postimeve dhe kontekstit në të cilin ato janë bërë, nuk rezulton ekzistenca e një qëllimi për të diskriminuar ankuesit si individë për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo fetare. Fjalori i përdorur është i lidhur drejtpërdrejt me konfliktin kolektiv të punës, me pretendime mbi aktivitetin ekonomik, me çështje të transparencës dhe me ndikimin në komunitetin lokal. Referencat ndaj origjinës së kapitalit apo shtetësisë janë integruar në argumentimin mbi dimensionin ekonomik dhe institucional të çështjes, jo si bazë për të kërkuar trajtim të pabarabartë civil apo juridik.

Elementi thelbësor që mungon është pikërisht synimi për të mohuar barazinë apo për të kërkuar përjashtim nga të drejtat për shkak të identitetit etnik apo fetar. Nuk ka në asnjë prej postimeve thirrje për kufizim të të drejtave civile, për ndalim aktiviteti për shkak të përkatësisë kombëtare, apo për trajtim institucional të diferencuar. Përmbajtja e tyre, edhe kur është e fortë dhe polemike,

është e orientuar ndaj veprimtarisë së një subjekti ekonomik dhe jo ndaj qenies së individëve si pjesëtarë të një grupi të mbrojtur.

Në mungesë të këtij elementi subjektiv, nuk mund të ekzistojë diskriminimi i drejtpërdrejtë. Kritikimi i ashpër i një biznesi apo i drejtuesve të tij për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit nuk përbën, në vetvete, shprehje të vullnetit për të diskriminuar në bazë etnie apo feje.

Në nenin 3/2, të LMD-së, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

LMD, në nenin 3/8 e tij, ka përcaktuar se, “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Pra, për gjuhën e urrejtjes, kërkohet që deklarimi të synojë ose të ketë potencial real për të nxitur armiqësi apo përjashtim ndaj një grupi si të tillë. Në rastin konkret, qëllimi i shprehur dhe i lexueshëm nga konteksti është mbrojtja e interesave të minatorëve dhe artikulli i një qëndrimi kritik ndaj aktivitetit të një shoqërie të caktuar. Ky është qëllim sindikal dhe ekonomik, jo diskriminues.

Deklarimet nuk janë drejtuar ndaj individëve si persona privatë në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërpersonale, por janë pjesë e një debati publik sindikal mbi aktivitetin e një subjekti ekonomik. Mjedisi ku janë bërë deklaratimet është hapësirë publike e debatit social, jo ambient pune apo raport hierarkik ku krijohet mjedis armiqësor në kuptimin juridik të ligjit.

Nuk rezulton që postimet të kenë krijuar një mjedis frikësues apo armiqësor ankuesit janë subjekt ekonomik me kapacitet të plotë veprimi, kanë ushtruar të drejtën e padisë civile, kanë paraqitur kallëzim penal dhe kanë akses të plotë në mjetet ligjore. Kjo tregon se nuk ndodhen në një situatë presioni strukturor apo pabarazie që ligji synon të parandalojë përmes kategorisë së shqetësimit.

Nëse disa formulime janë të ashpra, ato janë tipike për debatin polemik në konfliktet kolektive. Ligji nuk synon të ndëshkojë gjuhën e fortë në debat publik, por të parandalojë cenimin e dinjitetit për shkak të karakteristikave të mbrojtura në mënyrë të tillë që krijon përjashtim ose frikësim sistematik.

Përmbajtja e postimeve nuk përmbush as elementin e qëllimit për të krijuar mjedis armiqësor për shkak të një karakteristike të mbrojtur, as elementin e efektit objektiv të tillë. Për rrjedhojë, nuk ekziston as “shqetësimi” në kuptimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Referuar praktikës së KMD-së, për të ekzistuar diskriminim, gjuhë urrejtjeje apo shqetësim në kuptimin e ligjit nr. 10221/2010, duhet të provohet se shprehja në fjalë promovon, nxit, përhap ose justifikon urrejtje, denigrim apo trajtim më pak të favorshëm për shkak të një karakteristike të mbrojtur, si dhe se ajo tejkalon kufijtë e lirisë së shprehjes në kuptim të nenit 22, të Kushtetutës dhe nenit 10, të KEDNJ-së.

Sa më sipër, nëse nuk vlerësohet pushimi i shqyrtimit të ankesës, kërkohet konstatimi i mosdiskriminimit, për shkak të gjuhës së urrejtjes me nocion racor, fetar dhe etnik të ankuesve.”

- ***Në lidhje me kërkesën e KSSH-së se çështja lidhur me ankesën e shoqërisë “Tete Albania Tunnel & Mining” sha, pranë KMD-së, duhet të pushohet***

KSSH, kërkoi pushimin e shqyrtimit të ankesës, me argumentin se “referuar vetë përmbajtjes së padisë së paraqitur nga ankuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kundër KSSH-së, rezulton se nga shoqëria “Tete Albania Tunnel & Mining” sha, përveç dëmit pasuror nga zhvillimi i grevës të konsideruar prej saj si të paligjshme është kërkuar edhe dëmi jopasuror dhe në paragrafin 50, të padisë i referohen shprehimisht pretendimeve për thirrje raciste dhe provave që janë paraqitur edhe në procesin administrativ. Pasqyruar ky fakt edhe në paragrafin 6 të ankesës së paraqitur pranë KMD.

Për më tepër, të konfirmuara edhe nga deklaratimet e bëra në seancë nga vetë përfaqësuesi i palës ankuese, është pranuar se lidhur me të njëjtat pretendime është paraqitur edhe kallëzim penal pranë organit të prokurorisë.

Në këto kushte, objekti i shqyrtimit administrativ, po shqyrtohet edhe nga gjykata civile ashtu edhe nga organi prokurorisë, dhe se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe para Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.”

Në vijim, KSSH, shprehet se, “nëse nuk vlerësohet pushimi i shqyrtimit të ankesës, kërkohet konstatimi i mosdiskriminimit...”

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Neni 33 “Procedurat”, i LMD-së, përcakton se: “7/4. Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

Në bazë të akteve të administruara rezulton se, subjekti ankues ka depozituar në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë një kërkesë padi me objekt:

- “ 1. Shpalljen të paligjshme të grevave të datës 8,9,10,11,13,14,15 tetor 2025, e në vijim.*
- 2. Detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror (reputacional) në vlerën 50.000 lekë të shkaktuar palës paditëse.*
- 3. Detyrimin e palës së paditur për të paguar shpenzimet gjyqësore dhe avokatore”.*

Rezulton se nëpërmjet këtij procesi gjyqësor të filluar pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, subjekti ankues ka kërkuar gjyqësisht pagimin e dëmshpërblimeve në lidhje me dëmin jopasuror (konform nenit 609 e 625, të Kodit Civil).

Ndërsa lidhur me citimin e KSSH-së se “*për të njëjtat pretendime është paraqitur edhe kallëzim penal pranë organit të prokurorisë*”, pranë KMD-së nuk u depozitua asnjë akt që të verifikohet e konstatohet një pretendim i tillë.

LMD, ka parashikuar në nenin 34, pika 1, të tij se, çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente, ndërsa bazuar në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se, paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës.

Në vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, Gjykata e Lartë shprehet se: “*...një fakt i caktuar mund të sjellë lindjen e shumë marrëdhënieve juridike të njëkohshme apo të njëpasnjëshme. Marrëdhëniet juridike në fjalë qëndrojnë në themel të shkakut të padive respektive që mund të ngrihen nga subjektet pjesëmarrëse të këtyre marrëdhënieve juridike. Objekti i padisë ose kërkimi që i kundrejtohet palës kundërshtare mund të jetë i njëjtë në disa padi, por ato dallojnë nga njëra-tjetra sepse bazohen në shkaqe të ndryshme juridike.*”

Nga aktet e administruara nuk rezulton që subjekti ankues të ketë paraqitur në kërkesë padinë para Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kërkime me objekt konstatimin e diskriminimit dhe nuk ka për objekt dëmshpërblimin për shkak të diskriminimit të pësuar.

Kërkesë padia e paraqitur para Gjykatës ka objekt dhe shkak tjetër ligjor nga ankesa objekt shqyrtimi e paraqitur pranë Komisionerit. Subjekti ankues nuk ka pretenduar para Gjykatës kërkimin për diskriminim që ka paraqitur për trajtim para Komisionerit në këtë ankesë. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se çështja që subjekti ankues ka paraqitur para Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe çështja objekt shqyrtimi pranë Komisionerit nuk kanë të njëjtin objekt dhe kërkime dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë pengesë ligjore për shqyrtimin e saj, sipas nenit 33, pika 7 të LMD dhe nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile.

Sa më sipër, Komisioneri e vlerëson këtë kërkim të KSSH-së, për pushimin e shqyrtimit të ankesës në fjalë, si të pabazuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes nga Komisioneri

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë bazat e shtetit të së drejtës. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. (Neni 3, i Kushtetutës së Shqipërisë)

Liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të porealizueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkëekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përçmimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për genocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, fenomene të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t’i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon : *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore (*në vijim KEDNJ*), e cila në nenin 14, ndalon diskriminimin dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke sanksionuar: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, etnia , origjina kombëtare*

, ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”, si dhe Protokollin Nr. 12 të KEDNJ-së, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm. Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, KEDNJ, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Vendi ynë ka ratifikuar shumë prej traktateve për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili në nenin 2, pika 1, përcakton: *“1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo shkak tjetër.”*, ndërsa në nenin 26, ky Pakt sanksionon: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shkak tjetër.”*

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e parashikuar nga neni 22, ku sanksionohet: *“Liria e shprehjes është e garantuar.”*

Liria e shprehjes garantohet edhe në kuadër të akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Liria e shprehjes sanksionohet nga neni 10, i KEDNJ-së, ku përcaktohet : *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Liria e shprehjes garantohet edhe në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në nenin 19, të Paktit, sanksionohet se: *“1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur*

prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”

Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike. Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin, shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është subjekt i kufizimeve, sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite Kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij.

Neni 17, i KEDNJ-së, ndalon shpërdorimin e të drejtave, duke sanksionuar: *“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”*. Një ndalim të ngjashëm e gjejmë të formuluar edhe në nenin 5, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ku sanksionohet: *“I. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejta për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.”*

Sipas jurisprudencës së vendosur nga GJEDNJ, kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizim” ose “dënim” i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur”. (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Në nenin 3, pika 1, të LMD, sanksionohet se: “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Një nga format e shfaqjes së diskriminimit, është “gjuha e urrejtjes”, e cila përkufizohet në pikën 8, të nenit 3, të LMD, sipas përkufizimit vijues: “8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”

“Gjuha e urrejtjes”, si një nga format e shfaqjes së diskriminimit, është e ndaluar nga neni 5, pika 1, e LMD, ku sanksionohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

Sipas Rekomandimit nr. R(97) 20 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes”⁶, termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

⁶ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Rekomandimi Nr.15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015⁷, e përkufizon “gjuhën e urrejtjes”: “gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e racës, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit”.

Po sipas Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, vlerësimi nëse ekziston rreziku që aktet e mësipërme të ndodhin, duhet të merret duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përdoret “gjuha e urrejtjes”.

Në mënyrë të veçantë duhet të mbahet parasysh:

- a) konteksti në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes);
- b) aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose komunitar);
- c) natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi);
- d) kontekstin e komenteve specifike (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati);
- e) mediumin (formatin) e përdorur (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt");
- dhe f) natyrën e publikut (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi)⁸.

Në dy vendime, *Behar dhe Gutman kundër Bullgarisë* (nr. 29335/13, datë 16.02.2021) dhe *Budinova dhe Chaprazov kundër Bullgarisë* (nr. 12567/13, datë 16.02.2021), GJEDNJ, ka vendosur disa faktorë me rëndësi, (që nuk janë shterues) të cilët duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet, nëse deklaratat publike negative në lidhje me një grup shoqëror ngrihen mbi “*nivelin e ashpërsisë*” për t’u konsideruar diskriminuese. Faktorët me rëndësi, që sipas GJEDNJ duhet të merren në konsideratë janë:

1. Karakteristikat e grupit (për shembull madhësia e tij, shkalla e homogjenitetit, cenueshmëria e tij e veçantë ose historia e stigmatizimit dhe pozicioni i tij përballë shoqërisë në tërësi);

⁷ Në vijim referohet me akronimin Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t.

⁸ Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t, Relacioni Shpjegues, Pjesa B “Përkufizime”, nën-ndarja “Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes”, pika 16.

2. Përmbajtjen e saktë të deklaratave negative në lidhje me grupin (në veçanti, shkallën në të cilën ato mund të përcjellin një stereotip negativ për grupin në tërësi, dhe përmbajtjen specifike të atij stereotipi);
3. Formën dhe kontekstin në të cilin janë bërë deklaratat, shtrirjen e tyre (që mund të varet nga vendi dhe si janë bërë), pozicioni dhe statusi i autorit të tyre dhe shkalla në të cilën ato mund të konsiderohen se kanë ndikuar një aspekt thelbësor të identitetit dhe dinjitetit të grupit.

Sipas GJEDNJ-së, është ndërveprimi i të gjithë këtyre faktorëve që ka rëndësi. Pra, faktorët e sipërcituar duhen konsideruar në mënyrë kumulative që të mund të vlerësohet niveli i ashpërsisë.

Kufizimi i “gjuhës së urrejtjes” duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës, për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst, çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes, në raport me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pa dallim.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në LMD, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë diskriminimi e parashikuar nga ky ligj, është e ndaluar.

Në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132), përcaktohet se: *“Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.”*

Gjithashtu, rezulton plotësisht e qartë se, kufizimi i lirisë së shprehjes, të pretenduar nga subjekti, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi i personave për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre.

Në këtë mënyrë përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohet liria e shprehjes. Kushti i parë që kufizimi bëhet me ligj dhe në rastin konkret një kufizim i tillë përcaktohet në kuadër të LMD. Ndërkohë që, kushti i dytë, sipas të cilit kufizimi mund të justifikohet vetëm për shkaqet e përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta, për ligjet me faktin se, mbrojtja e të drejtave të personave që janë PAK, si në rastin objekt shqyrtimi, përbën një prej shkaqeve kufizuese të

përcaktuara nga Kushtetuta. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

“Gjuha e urrejtjes”, si një formë diskriminimi, sipas LMD-së, nënkupton përdorimin e një ose më shumë *formave të shprehjes*, përkatësisht, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo shpifjes të një personi ose grupi personash, si dhe çdo shqetësim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes, që bazohet në një listë të hapur të shkaqeve të mbrojtura nga diskriminimi, të parashikuara në nenin 1, të LMD-së, ku në mënyrë të shprehur parashikohet shkaku i etnisë, shtetësisë dhe bindjeve fetare.

Sipas LMD-së, “*shprehja*” përfshin, fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video, por edhe sjelljeje të caktuara, siç janë gjestet për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.

Pra, “*Gjuha e urrejtjes*”, lidhet me forma të ndryshme të shprehjes, që i drejtohen një personi apo grup personash, mbi bazën e statusit apo karakteristikave personale të personit apo grupit të personave dhe ekzistenca e kontekstit publik është kriter ligjor thelbësor. Shprehja konsiderohet e përdorur në publik kur ndodh në një vend/ambient fizik apo përmes mjeteve elektronike të komunikimit, në të cilat publiku i gjerë ka akses.

Sipas GJEDNJ-së, sulmi kundër reputacionit të personit/personave duhet të arrijë një nivel të tillë të rëndë, në mënyrë që të shkaktojë paragjykim të gezimit të së drejtës së respektimit të së drejtës nga individi/individët.

Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që prodhon apo krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehjet e kontestuara janë realizuar nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të facebook-ut të KSSH-së, në mënyrë publike, pasi janë bërë në Facebook, platformë kjo, e cila përfshihet në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Mediat sociale apo interneti, siç është cituar edhe në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, kanë një mundësi shpërndarje si kurrë më parë në një audiencë të madhe.

Pala ankuese ka evidentuar 9 (nëntë) postime në faqen zyrtare të facebook-ut të KSSH-së, duke pretenduar për përdorim të gjuhës së urrejtjes kundër: Shoqërisë “TETE Albania Tunnel & Mining

sha”, C. Y, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe H. U, me detyrë Drejtor Administrativ i kësaj Shoqërie.

Pranë KMD-së janë administruar në cilësi prove, postimet e depozituara nga pala ankuese, shkarkuar nga platforma Facebook e KSSH-së si dhe të transkriptuara, të cilat nuk janë kontestuar për mosvërtetësi nga ana e KSSH-së. Bazuar mbi sa ka pretenduar pala ankuese, për diskriminim e përdorim të gjuhës së urrejtjes, KSSH-ja ka depozituar kundërshtitë e objeksionet e saj (analizuar më poshtë në vendim).

Kontenti i kontestuar nga pala ankuese, i cili është objekt shqyrtimi në këtë çështje, është bërë publik përmes publikimit në faqen zyrtare të Facebook-ut të KSSH-së, dhe si të tillë postimet e subjektit konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar për efekt të hetimit administrativ postimet e transkriptuara, ku janë bërë deklaratimet të cilat janë marrë në shqyrtim.

Nga këqyrja e këtyre postimeve, lidhur me pjesët e pretenduara nga Shoqëria, Komisioneri saktëson se, ka analizuar gjuhën e përdorur, referuar transkripteve të secilit postim, të cilët i ka vlerësuar nëse potencialisht kishin premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes.

Në kontekst të gjuhës së përdorur në shkrimet e publikuara në faqen zyrtare të facebook-ut të KSSH-së, Komisioneri, vëren se:

Ka analizuar postimet në rrjetin social facebook të KSSH-së, respektivisht:

1. Me datë 20 Tetor 2025:

“Kush është T. U që kopsit bilancet e sulltaneve të Kurum dhe Albchrome në Bulqizë, aktiviteti i dyshimtë i H(bashkëshortit)”. Ia ku del dhe emri H. U i Tete Albania të Spaçit. Ne si faqe ua kemi thënë edhe më përpara që biznesi turk në Shqipëri funksionon si kartel me tentakula të shumta, jo shumë ndryshe nga kartelet e drogës. Duke përdorur rryshfetin dhe bajlozat e korrupsionit, bizneset turke kanë krijuar një kartel të jashtëligjshëm me ndikim jo vetëm në politiken shqiptare por dhe në media, prokurori, gjykata madje dhe SPAK. Në këtë kartel bën pjesë dhe ambasada turke bashkë me segmente të korrumpuara afër familjes së Erdogan. Me kulturën anadollake të të shkatërruarit e çdo gjëje për të ngritur pasuri, bizneset e këtij karteli ka vite që përveçse grabisin nëntokën tonë, na helmojnë dhe ajrin e ujin. Metalurgjikun e Elbasanit turqit, Munellen turqit, Spaçin turqit, Bulqizën e morën turqit, Kukësin turqit, HECet Ulëz, Shkopet, Bistricë i privatizuan turqit, në Mirditë HECin më të madh privat në vend e ndërtuan turqit Albtelekomin turqit etj etj. Të gjitha minierat e bakrit në vend i kanë turqit. Kush di të thotë sasinë e arit që po grabitet nga vendi e po shkon në turqi bashkë me bakrin? Turqit shtojnë pasurinë ndërsa ne shtojmë helmin, sëmundjet kancerogjene dhe fëmijët me autizëm dhe sindromen doën. Sa për Teten e Spaçit, të gjitha auditimet e kompanive prestigjioze të kontraktuara nga vetë turqit (Deloitte Audit Albania si dhe Grant Thornton), e nxjerrin kompaninë në rrezik financiar serioz dhe pa kapacitete, duke punuar nën rendimentin mesatar të industrisë. Pse ndodh kjo kur çmimi i bakrit në bursë nga 2500\$ toni është ngritur në gati 11000\$ toni, pra 4-fishuar?! Sepse kompania manipulon bilancet dhe del me humbje për të mos paguar taksat shtetit tonë. Këtu te internacionali duke pirë kafe raki i hodhëm

një sy bilanceve të Tete Albanias. Në pasqyrat financiare ka shumë probleme, sidomos me transferimin e miliona dollarëve kompanive mëmë në turqi pa i pasqyruar ne bilance (në 2020 transferohen 10 milion \$ fshehtas). Turqit janë në rregull “gjej shesh bëj përshesh”, në vendin e tyre i dërgojnë paratë. Ne çfarë bëjmë?!

2. Me datë 21 Tetor 2025:

“I futem një kafë mëngjesi dhe një teke këtu te internacionali duke shfletuar ca dokumenta të kompanive turke në vendin tonë. Pas tekës së dytë të rakis vumë re se financiera T. U e cila mban të gjitha financat e kompanive turke në Shqipëri, përveçse është bashkëshortia e Hasanit të Tete Albania të Spaçit, qënka dhe ortakë në biznes e E. D, i cili rastis që është bashkëshorti i H. Zj kryetares së gjykatës tonë kushtetuese. E. D paska qenë dhe drejtori i Albchrome. Pasi i futem teken e tretë për një gjë jemi bërë kurioz, kur H i Tete Albania mendon se sindikata është e jashtëligjshme pse nuk shkoi në prokurori e gjykatë për padi?! Pse rri indiferent e shpërndan lajme nëpër media kot?! Kush ia jep garancinë turqve të Tete Albania që nuk të hyn gjëmb në këmbë mos e ul kokën para ligjit dhe mirditorëve?! Çfarë lidhjesh kanë kompanitë turke me SPAK dhe a ka lobuar ambasada turke për disa prokurorë për të qenë pjesë e SPAK?! Po t’u futesh letrave e të ndjekësh fillin, në fund del që më prezente është ambasada turke në drejtësinë e re se sa ambasada amerikane.”

3. Me datë 21 Tetor 2025:

“Minatorët të vendosur për ta ndriçuar “Rrugën e mundimeve”! Dikur ndiznin zjarre për ta ndriçuar fëmijët dhe gratë familjare të burgosurve politike, kundërshtar të sistemit ! Sot ndezin zjarre minatorët për ta ndricuar “Rrugën e mundimeve” dhe mendjen e shpirtin e punëdhënësit aventurier dhe të pa përgjegjshëm që skllavëron minatorët, shkel mbi djersën dhe gjakun e tyre, përvetëson ekonominë kombëtare dhe shkatërron me shfrytëzim barbar rezervat miliona tonëshe të mineralit të bakrit, arit, argjentit dhe nënprodukteve të tjera të çmuara. Dinjitet për Minatorët!”

4. Me datë 25 Tetor 2025:

“Ky është realiteti, Pluhuri, tymi dhe bloza që lumturon minatorët sipas ndonjë freshdeputet që akoma flet shqip me mendësi anadulli se “Sindikata është e pa ligjshme”. Po kush janë të ligjshëm more shoku deputet, mirë se për grevën e për minatorët je pa fjalë, po si mirditor dhe nip mirditori po del dhe pa mend ! Koha do na gjykojë të gjithëve, por deri më sot ka treguar se politikanë dhe deputetë kanë interesa okulte me bizneset jo sindikata dhe minatorët . Ne kemi deputet senator, kemi E. B prandaj dëgjoje se po dëgjove shokun ke shkuar dam !!!”

5. Me datë 26 Tetor 2025:

“ Iku Turku ” “ Erdhi Turku ” ...edhe po iku, atëherë shqiptarëve u mbetet ari ...!

6. Me datë 26 Tetor 2025:

“Tani po duket qartë se “ku flen lepuri “. Presioni jo vetëm i Tete Albanias por fatkeqësisht dhe nga segmente politike e mediatike mbi ligjshmerinë e sindikatës apo ligjshmerinë e grevës nuk arriti të japë efekte në mashtrimin dhe shantazhin ndaj minatorëve grevistë. Pretendimet për

ndërprerje të aktivitetit mineral nuk e justifikojnë qëllimin e vërtetë të Tete Albania. Shqipëria është shtet tashmë në paradhomën e BE. Ajo ka ligjislacion të azhornuar me atë të BE, përfshi dhe ligjin mineral i cili përcakton qartë se kur ndërpritet dhe si ndërpritet aktiviteti në një minierë. KSSH po e ndjek situatën me shqetësim dhe po koordinon me strukturat përgjegjëse shtetërore duke mbrojtur dhe përfaqësuar minatorët me profesionalizëm dhe dinjitet e besnikëri. Por donim të theksonim një shqetësim të minatorëve. Ata kërkojnë nga Tete Albania të kthejë “arin e grabitur”. Nga përllogaritjet mesatare dihet që në zonat mineralmbajtëse të bakrit, minerali i bakrit shoqërohet me komponentë të tjerë të çmuar përfshirë dhe arin, komponentë këto pasuri kombëtare. Nga një ton koncentrat bakri përllogaritet teorikisht dhe nga përvoja 70 vjeçare e mirditorëve se përmban 13 deri 16 gram flori që populli i thotë ar dhe argjend. Nga Tete Albania janë raportuar çdo ditë të nxjerra rreth 70 ton koncentrat bakri ose 70 000 kg x 14,4 gr = 1 kg flori në ditë. Duke punuar 6 ditë në javë janë nxjerrë si komponent shoqërues 6 kg flori në javë, për 4 javë ose një muaj i bie mesatarisht 24 kg flori i nxjerrë si mineral bashkëshoqërues përfshi dhe komponentë të tjerë. Me sa kujtojmë ne si sindikatë, Tete Albania ndoshta jo me këtë emër por me këta aktorë që emri i tyre është i përfshirë në shumë biznese në Shqipëri ka filluar shfrytëzimin në vitin 2018 deri më tani 7 vite ose 84 muaj. 84 muaj x 24 kg flori/muaj bëjnë mesatarisht 2016 kg flori. Ne nuk e dimë më tej fatin e tij ..? Por nëse në kontratën e koncensionit është përcaktuar sipas Kushtetutës së Shqipërisë se duhet të ishte kthyer shtetit shqiptar deri më tani 2016 kg flori. Nëse kjo është harruar apo ka qenë një lapsus gabim në formulimin e saj, ne po e kujtojmë se duhet të kthehet dhe të paguhet për mirëqenien e minatorëve dhe gjithë shqiptarëve !”

7. Me datë 27/10/2025:

“Turqit e Tete Albania të akuzuar në Turqi për mashtrim financiar, korrupsion, pastrim parash dhe terrorizem! Duke pirë raki dhe mësuar turqisht, hulumentuam pak në internet se kush janë turqit e Tete Albanias, kush janë këta që grabisin Mirditën? Administratori i Tete Albania na del E. B, antar bordi dhe në disa raste drejtues i grupit Ilbak Holding, grup ky që zotëron 51% të aksioneve të Tete Albania, pra ortaku kryesor. Grupi Ilbak Holding sipas mediave turke njihet për lidhjet me politikën por dhe për mashtrime tatimore, pastrim parash, skema të jashtëligjshme dhe arrestime. Nuk dihet çfarë kontrolli bën SHISH, Drejtoria e Pastrimit Parave apo antiterrori ynë por disa nga pronarët turq të minieres së Spaçit akoma janë në arrest shtëpie në shtetin turk. Madje disa prej tyre akuzohen dhe të lidhur me terrorizmin. Në 2017 zyrat e E. B u bastisen nga policia turke. Sipas mediave turke ai akuzohet për një mashtrim financiar prej 150 milion lirash (mbi 3 milion euro) kundrejt televizionit shtetëror turk TRT. Emri i Eyupit figuron dhe në një çeshtje tjetër të rëndësishme në gjykatën e lartë turke. Në mars të 2025 (para 7 muajsh) pronarët turq të Ilbak Holding arrestohen nga policia turke, dhe bastisen zyrat e tyre. Konkretisht arrestohen M. I, M. I, Y. I dhe A. I. Pas disa muajsh në qeli pronarët e Spaçit kalojnë në arrest shtëpie. Sipas mediave turke, pronari i madh M. I i cili ka në pronësi dhe televizionin CNBC mori statusin e të penduarit dhe pranimit të fajt, gjë e cila e nxori nga qelia në arrest shtëpie. Shteti turk ka sekuestruar para, prona dhe aksione kompanish të grupit Ilbak Holding vetëm para disa muajsh. Sot nuk kemi asnjë llojë transparence nëse konçesionari i minieres së bakrit në Spaç, Tete Albania, është sekuestruar nga shteti turk apo jo. Ku përfundon ari i vjedhur i Mirditës?! Kështu bëhet gazetaria o sandri i partisë që ve kujën se do të na ikë Tete Albania nga Mirdita e do të mbesim pa bukë ne mirditorët.

Ia nga kush po i merr paratë nëndorë të sabotosh greven e vëllezërve të tu mirditorë o gazetari i partisë. Po ha suflaquet e terroristave turq e po intimidon minatorët e Spaçit me shkrime. Të mbarojmë njëherë me turqit se do të vijë rradha dhe ty të demaskohesh.”

8. Me datë 28.10.2025:

“Postim i një lajmi mediatik me titull “Mafiozët turq në Spaç zhvasin miliona euro...”

9. Me datë 03.11.2025:

“Administratori Turk, “Tutor arrogant” i Tete Albania po përpiqet të grumbullojë jenitqerë që ti miksojë me “robërit” e sjellë nga anadulli me qëllim thyerjen e grevës së ligjshme të Minatorëve të Spaçit ! Dhe fillimin e prodhimit të mineralit bakrit, arit, zinkut, argjentit etj! Ju bëjmë thirrje burrave të Mirditës, nipërve pasardhës të Gergj Kastriotit , Lekë Dukagjinit , P. P, Gj. Ll e dhjetra gjeneralë e kalorës të krishterimit të mos rreshtohen në kampin e turpit, në anën e H e të tradhëtarëve që shesin interesat kombëtare e shkelin kauzat, gjakun e djersën e minatorëve grevistë. Ata që sot shesin dhe shkelin mbi grevën e ligjshme të gjakut e të bukës, të nderit e të dinjitetit të minatorëve, nesër shesin nderin e nënave, motrave e vajzave tona që pranuan të sakrifikojnë jetën e tyre duke u hedhur në shkëmbin e vajës dhe nuk pranuan të bien në dorën e sulltaneve satrap të anadollit që sot në shekullin e 21 të Mirditës Europiane duan të na nxijnë floririn me qallmat e korrupsionit, mashtrimit e bashkëpunimit me Hanzatë tradhëtar të grevistëve e minatorëve të Spaçit!

Mjafton lajmi i përhapur nga mediat këto ditë dhe gjykimin do ta lemë në dorën e të madhit Zot! “Kompania Tete Albania Tunnel & Mining sha që zotëron konçesionin e minieres është në pronësi 51% të grupit Ilbak Holding në Turqi. Që prej muajt mars 2025, sipas mediave turke, pronarët e Ilbak Holding ndodhen të arrestuar në shtetin turk për mashtrime financiare, tendera korruptivë dhe akuza terrorizmi. Konkretisht me masë arresti nga shteti turk janë M. I, M. I, Y. I dhe A. I. Duke u referuar mediave turke, M. I i cili ka ne pronesi dhe televizionin CNBC në Turqi mori statusin e të penduarit dhe pranimit të fajt, gjë e cila e nxori nga qelia në arrest shtëpie. Shumë prona, llogari bankare dhe asete kompanish të grupit Ilbak Holding muajt e fundit janë sekuestruar nga shteti turk. Skandali bëhet dhe më i rëndë pasi institucionet e shtetit shqiptar po bëjnë të pamundurën që ky skandal mos të dalë për publikun shqiptar. Akoma sot, Ministria e Industrisë dhe ajo e Ekonomisë nuk kanë reaguar nëse kompania që zotëron minieren e Spaçit është e sekuestruar nga shteti turk në kuadër të hetimit për grupin Ilbak Holding në Turqi.”!

Në parantezë të analizimit të me sa më sipër, Komisioneri thekson faktin se, duhet bërë dallimi i shpërndarjes së një përmbajtjeje në kontekst debati sindikal dhe diskutimit publik mbi një çështje ekonomike dhe sociale.

KSSH, në rolin e saj si organizatë sindikale, ka funksion të artikulojë dhe të pasqyrojë qëndrimet e anëtarëve dhe komunitetit të punëmarrësve. Platforma e saj sociale shërben si mjet komunikimi kolektiv.

Në analizë të postimeve të kontestuara, respektivisht, Komisioneri vlerëson se:

Për sa i përket postimit datë 20.10.2025, edhe pse pala ankuese nënvizon fjalën turq në postim, ai përmban kritika të ashpra mbi strukturën e biznesit dhe pretendime për lidhje me korrupsion apo manipulime financiare. Këto janë pretendime të natyrës politike dhe ekonomike, të lidhura me aktivitetin e Shoqërisë, jo me përkatësinë etnike të individëve. Përdorimi i referencës ndaj origjinës, lidhet me kontekstin e debatit mbi kapitalin e huaj turk, ambasadës turke dhe ndikimin ekonomik, apo hamendësimin për lidhjet e ndikimin e paligjshëm në politikën shqiptare, mediat apo organet e drejtësisë.

Për sa i përket postimit datë 21.10.2025, përmban aludime mbi lidhje institucionale dhe ndikime në sistemin e drejtësisë. Këto janë pretendime në kuadër të hamendësimeve e aludimeve për konflikt interesi dhe transparencë, jo thirrje për diskriminim për shkak të racës apo fesë.

Në postimin e datës 21.10.2025, përdor gjuhë polemike në mbështetje të minatorëve dhe si kritikë ndaj punëdhënësit. Fokusi i postimit është raporti punëdhënës punëmarrës dhe pretendimet për kushtet e punës, jo identiteti etnik i drejtuesve.

Postimi i datës 25.10.2025, përmban gjuhë figurative në drejtim të politikës shqiptare. Evidentohet se shprehjet e përdorura janë shprehje me ngarkesë retorike, në kontekst të konfliktit sindikal dhe me perceptimin e padrejtësisë ekonomike dhe pakënaqësisë ndaj klasës politike shqiptare.

Postimi i datës 26.10.2025 është në kuadër të retorikës që edhe nëse largohet shoqëria turke ka përfitime në aspektin ekonomik, pasi ari që përftohet nga nxjerrja e mineralit në minierë është në pronësi të shqiptarëve.

Po në këtë kontekst dy postimet e kësaj date trajtojnë çështje të shfrytëzimit të burimeve minerare dhe ndikimin ekonomik në zone, në vijim të debatit mbi pasuritë natyrore dhe interesin kombëtar, i cili është debat publik legjitim.

Postimi i datës 27.10.2025, përmban komente për hetime të drejtuesve të shoqërisë tregtare turke dhe lidhje me çështje financiare. Edhe nëse referencat janë me tone të forta, ato kanë karakter informues dhe polemik mbi reputacionin e një grupi biznesi, dhe jo mbi të drejtat civile të një grupi etnik si kategori e veçantë.

Postimi i datës 28.10.2025, përdor terminologji të ashpër (“mafie”, “korrupsion”), që në jurisprudencën e GJEDNJ konsiderohet si gjuhë polemike në debat publik, jo domosdoshmërisht gjuhë urrejtjeje, për sa kohë nuk përmban thirrje apo shprehje drejtuar të gjithë komunitetit turk.

Është e dukshme dhe identifikuar vetëm personave të veçantë dhe pjesës së biznesit të përfolur të shoqërive të veçanta tregtare të huaja, që ushtrojnë veprimtari jo të rregullt e të ligjshme.

Komisioneri, në analizën e përmbajtjes së postimeve sipërcituar, ka në konsideratë faktin se, ato duhet të lexohen në kontekstin e një konflikti kolektiv pune dhe të një debati mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore, transparencën financiare dhe ndikimin në komunitetin lokal.

Në rastin konkret, referencat ndaj origjinës së kapitalit apo ndaj zhvillimeve në Turqi janë bërë në kuadër të debatit mbi aktivitetin ekonomik dhe reputacionin institucional të shoqërisë, jo si thirrje për përjashtim civil, social apo juridik të individëve për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Pavarësisht faktit se disa formulime mund të konsiderohen të ashpra, hiperbolike apo polemike, kjo nuk mjafton për t'i kualifikuar si diskriminim në kuptimin juridik të ligjit. Ligji kërkon ekzistencën e një trajtimi konkret më pak të favorshëm dhe një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me një karakteristikë të mbrojtur.

Opinionin, edhe kur është i ashpër, duhet analizuar në tërësinë e tij dhe në kontekst, duke bërë dallimin midis gjykimeve të vlerës dhe nxitjes reale të urrejtjes. Është theksuar se liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike dhe përfshin edhe të drejtën për të shprehur mendime që mund të jenë tronditëse, polemike apo të pakëndshme për një grup të caktuar, për sa kohë nuk synojnë dhe nuk prodhojnë efekt real nxitjeje të urrejtjes apo dhunës.

Shprehjet e përdorura gjatë një situatë debati të tensionuar, edhe kur përmbajnë tone emocionale apo etiketime personale, nuk përbëjnë automatikisht gjuhë urrejtjeje në kuptimin e nenit 3/8 të ligjit, nëse nuk evidentohet qëllimi për të nxitur urrejtje ndaj komunitetit në tërësi dhe nëse ato mbeten brenda sferës së debatit publik dhe shkëmbimit të opinionëve.

Postimet objekt shqyrtimi në çështjen konkrete nuk përmbajnë elementin e promovimit apo nxitjes së urrejtjes ndaj një grupi për shkak të një karakteristike të mbrojtur, por janë pjesë e një debati sindikal dhe social lidhur me çështje konkrete të marrëdhënieve të punës dhe aktivitetit të një subjekti ekonomik. Edhe nëse janë përdorur formulime të forta apo kritike, ato duhet të analizohen në kontekstin e konfliktit kolektiv dhe jo të shkëputura artificialisht nga rrethanat.

Duke ju referuar shprehjeve të përdorura në postimet sipërcituar, (pavarësisht faktit nëse janë postime të marra e të shpërndara nga faqe të tjera dhe jo vetë KSSH) për të cilat pala ankuese pretendon se nga KSSH është përdorur gjuhë urrejtje, Komisioneri konstaton që në tërësinë e tyre, postimet, nuk përmbajnë fjalë ose shprehje me natyrë të tillë që mund të konsiderohen si sulm i drejtpërdrejtë ose i nënkuptuar, ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të personave për shkak të “*racës, etnisë, shtetësisë dhe bindjeve fetare*”.

Komisioneri vëren se, postimet në fjalë, nuk kanë patur për qëllim stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, apo nxitjen e frikësimit, armiqësisë ose diskriminimit të subjekteve ankues për shkaqet e mësipërme. Pra, natyra e ashpërsisë së fjalëve të cituara nuk është e atij intensiteti apo natyre dhe as në qëllimin që përcjell në vetvete postimi, që të mund të konsiderohet se përbën veprim diskriminues apo të ketë elementë të gjuhës së urrejtjes kundrejt subjekteve ankues, për shkaqet e pretenduara.

Pavarësisht faktit, se *në parim*, gjuha e përdorur dhe fjalët e zgjedhura në postimet në fjalë, *mund e duhet* të ishin më të kujdesshme dhe sa më neutrale, Komisioneri nuk konstaton, ndonjë sulm abuziv apo të qëllimshëm specifikisht kundrejt subjekteve ankues, për shkaqet e pretenduara.

Komisioneri, thekson se, shprehje të ndryshme që mund të jenë fyese ose të karakterizuara nga paragjykime dhe që mund të ngrejnë shqetësime për mungesën e ndjeshmërisë, mund të mos përmbushin prapë e ashpërsisë për t'i përlegjur ato si “gjuhë urretjtje” dhe rrjedhimisht si një formë diskriminimi sipas LMD.

Komisioneri thekson se, *gjuha e urretjtjes*”, konsiderohet e tillë, kur ajo përdoret që të nxisë apo krijon pritshmërinë që të ketë efektin e nxitjes, drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shenjëstruar, që në rastin konkret pretendohet nga pala ankuese se janë për shkak të “racës, etnisë, shtetësisë dhe bindjeve fetare”.

Komisioneri, vlerëson se, fjalët dhe shprehjet e përdorura në postimet e evidentuara më sipër, nuk janë të tilla që të nxisin apo krijojnë pritshmërinë që të kenë efektin e nxitjes, drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shenjëstruar, në mënyrë që të përmbushin prapë e ashpërsisë të kërkuar për t'u konsideruar “gjuhë urretjtje”, sipas LMD. Dukshëm, shprehjet e përdorura në postimet e analizuara nuk përlegjin kufizimin e lirisë së shprehjes.

Në përfundim, as nga aspekti i autorësisë, as nga analiza materiale e përmbajtjes dhe as nga standardi i përgjegjësisë në hapësirat dixhitale, nuk rezultojnë përmbushja e elementeve përbërës të diskriminimit.

Në rastin konkret, nga analiza e tërësisë së postimeve dhe kontekstit në të cilin ato janë bërë, nuk rezultojnë ekzistenca e një qëllimi për të diskriminuar ankuesit si individë për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo fetare. Fjalori i përdorur është i lidhur drejtpërdrejt me konfliktin kolektiv të punës, me pretendime mbi aktivitetin ekonomik, me çështje të transparencës dhe me ndikimin në komunitetin lokal. Referencat ndaj origjinës së kapitalit apo shtetësisë janë integruar në argumentimin mbi dimensionin ekonomik dhe institucional të çështjes, jo si bazë për të kërkuar trajtim të pabarabartë civil apo juridik.

Elementi thelbësor që mungon është pikërisht synimi për të mohuar barazinë apo për të kërkuar përjashtim nga të drejtat për shkak të identitetit etnik apo fetar. Nuk ka në asnjë prej postimeve thirrje për kufizim të të drejtave civile, për ndalim aktiviteti për shkak të përkatësisë kombëtare, apo për trajtim institucional të diferencuar. Përmbajtja e tyre, edhe kur është e fortë dhe polemike, është e orientuar ndaj veprimtarisë së një subjekti ekonomik dhe jo ndaj qenies së individëve si pjesëtarë të një grupi të mbrojtur.

Në mungesë të këtij elementi subjektiv, nuk mund të ekzistojë diskriminimi i drejtpërdrejtë. Kritikimi i ashpër i një biznesi apo i drejtuesve të tij për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit nuk përbën, në vetvete, shprehje të vullnetit për të diskriminuar në bazë etnie apo feje.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ngritur nga pala ankuese se shprehjet e përdorura në postimet e mësipërme nxisin urretjtjen, është i pabazuar.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në konkluzionin se, shprehjet dhe gjuha e përdorur në postimet e kontestuara nuk përbën “gjuhë urrejtje⁹” në kuptim të nenit 3, pika 8, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk konstaton shkelje të ligjit.

Lidhur me postimin i bërë nga KSSH me datë 03.11.2025, Komisioneri konstaton se pjesa e pare e këtij postimi, duke evokuar figura, simbole e ngjarje historike të mesjetës, të sjella në kontekstin e konfliktit KSSH – “Tete Albania Tunnel & Mining” sha, dukshëm përmban gjuhë përçarëse dhe që mund të nxisë sjellje diskriminuese.

Por, Komisioneri e vlerëson këtë si një moment të veçuar, i cili nuk ka qëndruar për një kohë të gjatë i postuar në këtë platformë sociale që të ketë përcjellë në publik shqetësim apo të krijojë dyshime për ndonjë ndikim të mundshëm negativ i cili të ketë afektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi ankuesit për shkaqet e pretenduara, pasi postimi është hequr nga vetë KSSH të nesërmen e postimit të tij¹⁰.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, KSSH, ka reaguar pozitivisht, duke marrë masa konkrete efektive, (pavarësisht kontekstit e ashpërsisë apo gjuhës së papërshtatshme të përdorur në këtë postim) duke e hequr vetë postimin, pasi e ka vlerësuar të gabuar.

Theksojmë se, Komisioneri ka pasur dhe ka vazhdimisht në vëmendje, faktin që përdorimi i mjeteve në median e shkruar, atë audiovizuale apo rrjeteve sociale për të reklamuar, duke bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht në përcjelljen e këtyre qëndrimeve që të mos kuptohen si deklarata fyese ndaj individëve, grupeve apo komuniteteve të veçanta të shoqërisë.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave që i jepen prej ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së papërshtatshme me konotacione diskriminuese nga persona publik. Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar përdorimin e gjuhës fyese, shqetësuese, apo shkrimeve e publikimeve me natyrë paragjyquese e diskriminuese ndaj një grupi apo komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike, qofshin ato subjekte fizike apo juridike.

⁹ Nga praktika e KMD-së për rastet e ngjashme, citojmë vendimet e Komisionerit, me: nr. 218/2021, nr. 233/2021, nr. 109/2022, nr. 250/2023.

¹⁰ Postimi i bërë nga vetë KSSH me datë 03.11.2025, është hequr brenda 24 orëve si postim (pala ankuese e ka printuar atë tek noteri publik 12 orë pas postimit), ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm në faqen e KSSH-së. KSSH e ka hequr vetë postimin pa u paraqitur ankesa pranë KMD-së

Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Komisioneri vlerëson reagimin e KSSH-së, lidhur me reflektimin në kuadër të gjuhës e retorikës së përdorur prej saj në postimin e datës 03.11.2025, duke e hequr atë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit në formën e “*gjuhës së urrejtjes*”, për shkak të “*racës, etnisë, shtetësisë dhe bindjeve fetare*”, kundrejt Shoqërisë “TETE Albania Tunnel & Mining sha”, CY¹¹ dhe H. U¹², nga ana e Konfederatës së Sindikatave në Shqipëri dhe Presidentit të saj, K. N.
2. Rekomandohet që KSSH të ketë në vëmendje respektimin e standardeve të lirisë së shprehjes pa abuzuar me këtë të drejtë, të jetë e kujdesshme në publikimet, postimet, gjuhën e përdorur e materialet e shpërndara prej saj, në respektim të parimit të mosdiskriminimit, duke evituar përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)

¹¹ Me detyrë Drejtor i Përgjithshëm pranë kësaj Shoqërie.

¹² Me detyrë Drejtor Administrativ i kësaj Shoqërie.